

**STATUTI DHE AKTI THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
KD PRO SPORTS MANAGEMENT SHPK**

Sot ne date 18/11/2024, me cilesine e “Ortakeve themelues”:

**Z. Kastriot Dermaku**, atesia Luan, i datëlindjes 15.01.1992, lindur ne Itali dhe banues ne Njësia Administrative Nr. 2, rruga e Elbasanit 1003, Tiranë, shtetas Shqiptar, mbajtës i Pashaportes me Nr. BR9459591 dhe nr. personal J20115093P.

me vullnet të lire, të plete dhe të sinqerte, ka hartuar këtë statut te Shoqerise “**KD Pro Sports Management**” shpk, ne respekt dhe bazuar:

- Ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi;
- Ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare ”;
- Ne ligjin “ Per Qendren Kombëtare te Regjistrimit ”;
- Ne legjislacionin Fiskal e Tatimor;

ka themeluar një Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “**KD Pro Sports Management**”.

**Neni 1  
Emertimi**

Shoqeria gezon emerin **KD Pro Sports Management shpk** dhe eshte person juridik i te drejtës shqiptare, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

**Neni 2  
Selia**

Shoqeria e ka seline ne Durres, Njësia Administrative Nr. 5, rruga e Kosovarve, kati nr. 7, apartamenti nr. 4. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqiperise, me kerkese te administratorit ose me vendim te Ortakeve.

**Neni 3  
Kohezgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Vendosja e mëpasshme e një kufizimi në kohe është kompetencë e mbledhjes se asamblesë se Ortakeve te Shoqërisë.

**Neni 4  
Objekti i veprimtarise**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jetë:

Krijimi dhe manaxhmi i ekipeve te futbollit, manaxhimi dhe perfaqesimi i lojtareve te futbollit. Organizimi i eveneteve dhe kompeticioneve sportive te organizuara nga Federata

Shqiptare e Futbollit dhe UEF, brenda dhe jashtë vendit. Edukimi, stervitja cilesore dhe permiresimi atletik e teknik i futbollisteve te rinj duke filluar qe nga grup moshat e vogla. Zhvilimi i kurseve formuese per trajnere futbolli, futbollista, arbitra dhe edo pozicion qe perfshihet ne skemen e zhvillimit te sportit te Futbollit. Ofrimi i sherbimeve administrative, koordinimi dhe konsultimi ne promovimin e sportit. Organizim evenete sportive. Bar - Kafe. Restoran. Hoteleri. Palester. Marrje apo dhenie me qira te pasurive te paluajtshme apo te luajtshme. Te gjithe aktivitetet plotesuese ne perputhje me legjislacionin ne fuqi me qellimin e ndihmeses se shoqerise per arritjen e objektivave te percaktuara.

### **Neni 5 Kapitali themeltar**

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte 100'000 (njeqindmije) leke i ndare ne 1 (nje) kuote, vlera e te ciles zoterohet nga Ortaket si me poshte:

- **Z. Kastriot Dermaku**, zoterues i 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit me vleren 100'000 (njeqindmije) leke.

### **Neni 6 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i Shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të Kapitalit Themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë apo financime ne cash, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakeve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin te nenit perkates te statutit, kapitali fillesatar eshte i pataksueshem. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpëra datës së mbledhjes së Asamblese se Ortakeve thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 te ketij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej Shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragarfi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e Shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

### **Neni 7 Transferimi i kapitalit ndermjet Ortakeve apo ne persona te trete**

Kuotat e kapitalit të një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim e nenshkruar personalisht nga dhe vetem prej Ortakut perfaqsues apo personit te prokuruar prej tij.

Kuotat per shitje i propozohen me pare repektivisht Ortakeve te Shoqerise per nje afat 30 dite, pas kalimit te ketij afati ato jane lirisht te transferueshme ndaj cdo personi te interesuar.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

### Neni 8 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i Shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi vendimmarres i Shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e Shoqerise.

#### Asambleja e Ortakeve, vendos dhe përgjigjet për cështje si :

- përcaktimi i politikave tregtare të Shoqërisë;
  - emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - përcaktimin e shpërblimeve
  - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve periodike të ecurisë se veprimtarisë;
  - përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakeve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - investime, transferime kuotash, etj;
  - vendimet për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve apo te papublikuara ne rregjistrin tregtar ne QKR, janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur Shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

### Neni 9 Mbledhjet e asamblese se Ortakeve

Nëse nuk përcaktohet një vend tjetër, Asambleja e Ortakeve i mban mbledhjet e saj në selinë e Shoqërisë.

Mbledhjet e Asamblese se Ortakeve do të mbahen jo më pak se 2 (dy) herë në vit, ose mbledhja pasardhëse e Asamblese se Ortakeve do të jetë me një distancë kohore jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga mbledhja paraardhëse.

Çështjet që kërkojnë miratimin e Asamblese se Ortakeve mund të komunikohen me poste te zakonshme apo edhe me poste elektronike (email) dhe keto komunikime jane te vlefshme kur konfirmohen dhe nenshkuhen nga Ortaket, anetare te Asamblese.

Thirrja dhe vendimet e Asamblese se Ortakeve janë të vlefshme kur procedurat kryhen ne perputhje me Ligjin e Shoqerive Tregtare. Nëse, si rrjedhim i thirrjes se pare te Asamblese, nuk realizohet kuorumi nevojshem, mbledhja e Asamblese do të shtyhet për një datë te dyte



ne distance kohore prej 10 ditesh nga e para dhe, ne rast se edhe ne kete mbledhje te dyte mungon vendimmarja, Ortaket pranojne vleresimin e kuotave (cmimin per shitje) brenda nje afati prej 7 ditesh dhe me pas ofrojne kalimin e tyre midis njeri-tjetrit, sikurse eshte theksuar ne Nenin 7 ketu, me nje afat brenda 30-ditesh. Pas kalimit te afatit prej 37 ditesh kuotat behen lirisht te transferueshme per shitje kundrejt cdo personi te interesuar per to.

Njoftimi per thirrjen e mbledhjes se Asamblese dhe materialet per diskutim, nisen me poste fizike (poste te zakonshme) ose elektronike, minimumi 7 dite para dates kur do zhvillohet mbledhja e radhes. Kur te gjithe Ortaket jane dakort, mbledhja mund te zhvillohet ne cdo date. Ortaket, me vendim Asambleje, depozitojne prane Shoqerise adresat e postes elektronike ku duan te marrin dhe nga ku do tu perjigjen komunikimeve te Shoqerise. Ndryshimet e adreses se postes elektronike duhet ti komunikohen Administratorit te Shoqerise me poste fizike, me leter rekomandë ose me poste elektronike dhe deri kur komunikimi per ndryshimin e adreses elektronike nuk ka mberritur do konsiderohet e vlefshme adresa egzistente ne arkivat e Shoqerise.

**Neni 10**  
**Administrimi**

Emërimi i Administratorit të Shoqërisë është kompetencë e Asamblese se Orakeve. Administrator i Shoqerise emerohet për një afat 5 (pese) vjet me të drejtë riemërimi dhe do të jetë ortaku vijues:

- **Z. Kastriot Dermaku**, atesia Luan, i datëlindjes 15.01.1992, lindur ne Itali dhe banues ne Njësia Administrative Nr. 2, rruga e Elbasanit 1003, Tiranë, shtetas Shqiptar, mbajtës i Pashaportes me Nr. BR9459591 dhe nr. personal J20115093P.

**Administratori ka kompetencë, mban pergjegjesi dhe ka per detyre:**

Administratori ka koperanca e pergjegjesi sipas ligjit nr. 9901 date 14.04.2008, " Per tregtarët dhe Shoqerite tregtare".

**Neni 11**  
**Inventari, Pasqyrat dhe Viti Financiar**

Viti financiar fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

Përjashtimisht, viti i parë financiar do të fillojë në datën kur Shoqëria është regjistruar dhe mbaron më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.

Në përfundim të çdo viti financiar, administratori përgatit inventarët, pasqyrat financiare dhe raportin gjithëvjetor të administrimit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi mbi kontabilitetin. Po ne vijim Administratori dhe konsulentet financiar, qe kontraktohen nga Shoqeria, pasqyrojne ne analize shpenzimet dhe risqet fiskale, planifikojne buxhetet vjetore dhe i propozojne Asamblese se Orakeve politika per te ardhmen e Shoqerise.

Fitimi neto i realizuar që ka rezultuar pas zbritjes së shpenzimeve si dhe vlerës së fondit rezervë, u kalon Orakeve në përputhje me përqindjen e kontributit të tyre në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë ose mund të kalojë për investime, por gjithmone bazuar ne një vendim të shkruar te Asamblesë së Orakeve.

Bartja afatgjate e detyrimeve financiare te Shoqerise kundrejt te treteve, institucionë bankare apo individive, ndalon Asamblene e Orakeve ne ndarjen e dividenteve me prioritet permirsimin e gjendjes financiare te Shoqerise dhe rritje te perjegjesise dhe perparsise per fondet qe Shoqeria mobilizon per aktivitetin e saj tregtar kundrejt te treteve duke i dhene perparesti ketyre te fundit.

Mbledhja e Asamblesë së Ortakeve ka te dreje dhe mund të krijojë edhe lloje të tjera fondesh, apo rezervash përveç fondeve të parashikuara këtu.

Neni 12  
Baza ligjore

Shoqeria do te zhvillje aktivitetin ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjiskacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Shoqëria: **KD PRO SPORTS MANAGEMENT shpk**

ORTAKU I VETEM

Z. Kastriot Dermaku

*Kastriot Dermaku*

*[Handwritten signature]*